

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-71/2015

**Prishtinë,
27 korrik 2017**

Në çështjen juridike të:

Jugokoka e përfaqësuar nga B. L. I.

Pala ankuese

kundër

F. K. e përfaqësuar nga Shoqeria e Avokatëve “S & Q”-Prishtinë

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Erdogan Haxhibeqiri, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/240/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA08054), të datës 30 Prill 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 27 korrik 2017 mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Jugokoka e përfaqësuar nga B. L.I. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/240/2014, të datës 30 Prill 2014, për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA08054.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/240/2014, i datës 30 Prill 2014, për sa i takon kërkesës me numrin KPA08054.

ërmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale

1. Më 14 Dhjetor 2006, Jugokoka e përfaqësuar nga M. L. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkonte ri-posedimin e lokalit afarist. Ai pretendon se Ndermarrja Aksionare “Jugokoka” të cilën e përfaqëson është pronare e lokalit afarist me sipërfaqe prej 20.69 m², që ndodhet në rrugën “Dardania” lamela 1.3, lokal 4/II, Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar).
2. Për të mbështetur kërkesën e saj, pala ankuese kishte dorëzuar në AKP provat vijuese:
 - Kontratën mbi bashkimin e punës dhe mjeteve në mes të Entit për Urbanizëm, Projektim, Konsaltong dhe Inxhinjering të Kosovës dhe Shoqërisë Aksionare “Jugokoka” nga Beogradi të cilën e përfaqëson M.L.. Kontrata ishte e lidhur me 10 Shkurt 1992 e protokoluuar në evidwencat e palëve por e pa vërtetuar në Gjykatë
 - Aktvendim Nr 35045/2005 datë 8 Korrik 2005 mbi regjistrimin në regjistrat e subjekteve ekonomike të Serbisë në Beograd.
 - Letërnjoftim i M. L. i lëshuar nga autoritetet e qytetit në Beograd me 10 tetor 1997.
 - Kontratë mbi marrjen e kredisë e lidhur në me Investbanka DD Beograd dhe Jugokoka Nr. 02/28 datë 13 Shkurt 1992.
 - Certifikatë Vdekje e datës 11 Gusht 2013 që dëshmon se M. L. ka vdekur me 22 Janar 2013.
 - Certifikatë e lindjës e lëshuar me 11 qershor 2013 që dëshmon se B.L.-I. është e bija e M.
 - Shkresë drejtuar AKP-së datë 28 Shkurt 2014 me të cilën midis tjerash kërkesën e mer për sipër B. L.-I. është e bija e M.
 - Aktvendim i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.Nr. 1663/2004 datë 22 Shkurt 2007 me të cilin kjo gjykatë deklaroje moskompetencën dhe dërgimin lëndës AKP-së.
3. Njoftimi i kërkesës ishte bërë më 18 Korrik 2008 ku ishte vërtetuar se prona ishte një dyqan që përdorej nga F. K. Ajo kishte nënshkruar formën e pjesmarrjes në procedurë dhe pretendon se objekti ishte i papërfunduar dhe nuk ishte në shfrytëzim para konfliktit nga askush. Familja e saj kan investuar dhe e kan adoptuar për biznes të tyre.
4. Për të mbështetur pretendimet e saja ajo kishte dërguar një Deklaratë në AKP dhe në varg faturash në emër të ndërmarrjes Private pa ndonjë relevancë për çështjen konkrete.
5. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte gjetur vetëm kontratën e pavërtetuar në Gjykatë e cila gjendej në arkivën e palëve kontraktuese .
6. Më 30 Prill 2014, KKKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/C/240/2014 e kishte refuzuar kërkesën e palës ankuese me arsyetimin në paragrafin 38 se Pala ankuese nuk e kishte dëshmuar se e ka humbur posedimin si pasojë e konfliktit sepse nuk ka dëshmuar

pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit gjatë viteve 1998-1999.

7. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 10 Shtator 2014, ndërsa ajo kishte paraqitur ankesë më 8 tetor 2014. Pala përgjegjëse e ka pranuar vendimin e KKPK-së me 5 Shtator 2014.

Pretendimet e palës ankuese

8. Pala ankuese ka kundërshtuar vendimin e KKPK-së duke theksuar se vendimi mbështetet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe mbi shkeljen e të drejtës materiale dhe asaj procedurale.
9. Sipas palës ankuese, B. L. I. është pronare e pronës së kërkuar bazuar në provat e dorëzuara. Ajo nuk e ka të qartë se përse është refuzuar kërkesa dhe përse Sekretaria Ekzekutive e AKP-së nuk ka mundur të verifikoj dokumentet që e dëshmojnë të drejtën e saj pronësore përkundër faktit se sipas saj, ajo ka dorëzuar provat me të cilat mund të shihet se ajo është bashkëpronare.
10. Pala ankuese përsërit pretendimet e njëjta si në shkallë të parë duke prezantuar sërish dokumentet e njëjta të cilët tashmë ishin marrë në konsideratë nga KKPK-ja.

Pranueshmëria e ankesës

11. Ankesa ishte paraqitur brenda 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.

Arsyetimi ligjor

12. Gjykata Supreme shqyrtoi vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (në tekstin e mëtejshëm: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese gjeti se ankesa është e pabazuar.
13. Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marr vendim të drejtë kur ka refuzuar kërkesën duke arsyetuar se pala ankuese ka deshtuar të dëshmoi ndonjë të drejtë pronësore para ose gjatë konfliktit.
14. Sipas nenit 3.1 të Ligjit 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër nga KKPK-ja për ri-posedimin e pronës, nëse paraqitësi i kërkesës “e dëshmon” të drejtën e tij pronësore apo të drejtën për shfrytëzimin e pronës private, përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, dhe gjithashtu e dëshmon se ai /ajo nuk është në gjendje të ushtroj të drejtën në fjalë për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 apo për shkak të rrethanave që rezultojnë nga ky konflikt.
15. Sipas kësaj dispozite ligjore, pala ankuese është dashur të dorëzonte prova në mbështetje të kërkesës së saj për të dëshmuar të drejtën e pronësisë/ apo të drejtën për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme.
16. KKPK-ja e mbështet vendimin e saj mbi faktin se pala ankuese nuk ka dorëzuar asnjë provë që ka mundur të verifikohet nga AKP-ja, se ajo si bartëse e të drejtës pronësore gëzon ndonjë të drejtë pronësie mbi pronën, si dhe në faktin se Sekretaria Ekzekutive *ex officio* nuk kishte gjetur prova të tilla.
17. Prova e vetme që i referohet palës ankuese si ronare është kontrata e pavërtetuar në gjykatë e cila di e tillë nuk konstituon të drejtën pronësore të pretenduar.

18. Ankesa e palës ankuese ri-sjell pretendimet e njëjta që ajo i kishte theksuar para KKPK-së. Me ankesën ajo nuk kishte dorëzuar asnjë provë të re.
19. Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka lëshuar vendim të drejtë dhe të bazuar pas një procedure të rregullt. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.
20. Nga ajo që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 nën-paragrafi (c) të Ligjit nr. 03/L-079 është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Erdogan Haxhibeqiri, gjyqtar

Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it